

20151945374

L I G J
PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
TË DETYRIMEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT PËR MBINDËRTIMIN DHE ZHVILLIMIN E RRUGËVE, QË DO TË
LIDHET NDËRMJET BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM - BANKËS BOTËRORE DHE NP PËR RRUGË SHTETËRORE

Neni 1

Në Ligjin për garanci të Republikës së Maqedonisë të detyrimeve sipas Marrëveshjes për hua për financimin e Projektit për mbindërtimin dhe zhvillimin e rrugëve, që do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Bankës Botërore dhe NP për rrugë shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 129/15), pas nenit 5 shtohet nen i ri 5-a, si vijon:

"Neni 5-a

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve i kryer ndaj NP për rrugë shtetërore, të dedikuara për realizimin e Projektit për mbindërtimin dhe zhvillimin e rrugëve, financuar me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtë të heqjes së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/mallrave nga ana e NP për rrugë shtetërore, të dedikuara për realizimin e Projektit për mbindërtimin dhe zhvillimin e rrugëve, financuar me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrimeve doganore, si dhe nga akciza gjatë importit të automobilave për udhëtarë dhe vajrave mineralë.

Për qarkullimin që është kryer ndaj NP për rrugë shtetërore për qëllimet e realizimit të Projektit për mbindërtimin dhe zhvillimin e rrugëve, financuar me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji, për të cilën i njëjti është debitor tatimor në pajtim me nenin 32 pika 4 dhe neni 32-a nga Ligji për tatim mbi vlerën e shtuar, lirohet nga obligimi që të përlllogaritë dhe paguajë tatim mbi vlerën e shtuar.

Detyrësi tatimor i cili kryen qarkullim të liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (emërtimit) të pranuesit të të mirës ose shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë e shënon edhe emërtimin e projektit dhe emërtimin e Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji.

NP për rrugë shtetërore gjatë importit të të mirave të liruara në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, organit kompetent doganor detyrimisht i dorëzon kopje nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe deklaratë se të mirat/mallrat e importuar janë dedikuar për realizimin e Projektit për mbindërtim dhe zhvillim të rrugëve, financiar me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".